

PROCESVERBAL
nga vazhdimi i seancës së 23-të e Këshillit të Agjencisë së Shërbimeve
Mediatike Audio dhe Audiovizuele
të mbajtur me datë 18.08.2026

Anëtarët e Këshillit të Agjencisë të pranishëm nëpërmjet lidhjes video-konferencë: mr. Sasho Stefanovski, mr. Zirjeta Jajaga, Afrona Vërzivolli, Cvetanka Minovska, Petar Xhurovski, Viktor Pavlovski, mr. Gordana Majnova.

Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: /

Në seancë nëpërmjet lidhjes video-konferencë ishte i pranishëm dhe dr. Zoran Trajčevski, drejtori i Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Të punësuar nga shërbimi profesional të pranishëm nëpërmjet lidhjes video-konferencë: mr. Dragica Ljubevska, dr. Ivana Stojanovska, mr. Emilija Janevska, Cvetanka Mitrevska, mr. Ruzhica Boshnjakoska-Jotevska, Sergej Todorovski.

Të pranishmit e tjerë: /

Kryetari i Këshillit, mr. Sasho Stefanovski, hapi vazhdimin e seancës së 23-të të Këshillit. Seanca filloi në ora 13:00 dhe u mbajt nëpërmjet lidhjes video-konferencë. Në seancë u shqyrtua pika 2 nga seanca e 23-të "Propozim-vendim për përcaktimin e listës së ngjarjeve me rëndësi të madhe për publikun e RMV-së", e cila u anulua.

Pika 2

Këshilltarët mr. Zirjeta Jajaga dhe Afrona Vërzivolli propozuan në pjesën në të cilën përcaktohen kriteret për transmetuesit e kualifikuar për transmetimin e ngjarjeve me rëndësi të madhe, konkretisht në pikën 5, paragrafi (1), pas kriterit të katërt, të shtohet paragraf i ri, në të cilin thuhet:

"Gjatë përcaktimit të transmetuesve të kualifikuar, veçanërisht mirret parasysh transmetuesi i cili, përveç përmbushjes së kriterëve në fjalë, kryen veprimtari me interes publik dhe ka detyrim të ofrojë shërbime programore televizive dhe radio me rëndësi për realizimin e interesave të publikut në tërësi".

Zëvendësja e kryetarit të Këshillit të Agjencisë mr. Zirjeta Jajaga, shpjegoi se ndryshimi i propozuar ka për qëllim të forcojë më tej interesin publik në përcaktim se cilët radiodifuzerë mund të transmetojnë ngjarje me rëndësi të madhe. Ajo deklaroi se kriteret ekzistuese kryesisht i referohen mbulimit mediatik, arritshmërisë së shërbimit programor, transmetimit të pakoduar dhe ofrimin e përmbajtjes në gjuhën maqedone. Këto kriterë janë me rëndësi të veçantë për të siguruar qasje të gjerë dhe jodiskriminues publik në ngjarje, por ato nuk e marrin mjaftueshëm parasysh rolin që luajnë disa transmetues në përmbushjen e interesit publik në fushën e transmetimit. Ngjarjet me rëndësi të madhe kanë një vlerë të veçantë shoqërore dhe transmetimi i tyre nuk duhet konsideruar vetëm nga perspektiva e disponueshmërisë komerciale, prandaj ata propozojnë që gjatë përcaktimit të transmetuesve të kualifikuar, të merret parasysh dhe funksioni i tyre në interes publik.

Ndërkohë, shpjeguan se ndryshimi i propozuar nuk nënkupton përjashtimin e transmetuesve të tjerë që plotësojnë kriteret e përcaktuara, as nuk kufizon të drejtën e tyre për t'u kualifikuar për transmetimin e ngjarjeve me rëndësi të madhe. Përkundrazi, kriteret themelore të kualifikimit mbeten të pandryshuara dhe vazhdojnë të zbatohen në mënyrë të barabartë për të gjithë transmetuesit që plotësojnë kriteret. Kjo ruan mundësinë që të gjithë transmetuesit që plotësojnë kriteret e përcaktuara të kualifikohen, ndërkohë që lejon gjithashtu që të merret në konsideratë roli specifik i transmetuesve që kanë vendosur detyrime në përmbushjen e interesit publik. Në këtë mënyrë, sigurohet një ekuilibër midis parimit për qasjes së barabartë për transmetuesit dhe nevojës, kur transmetohen ngjarje me rëndësi të madhe, për të marrë në konsideratë funksionin publik të transmetuesit, duke forcuar kështu më tej mbrojtjen e të drejtës së publikut për qasje në këto ngjarje.

Drejtori i Agjencisë, dr. Zoran Trajčevski sugjeroj se propozimi i dhënë nga këshilltaret është i pranueshëm, duhet të jetë pjesë përbërëse e propozim-vendimit dhe propozoi që Këshilli ta miratojë.

Këshilltarja Gordana Majnova kërkoi sqarim nëse shtesa do të ishte juridikisht e detyrueshme me ligj ose është vetëm rekomandim.

Drejtori Trajčevski shpjegoi se bëhet fjalë për vendim, përkatësisht për akt nënligjor dhe gjatë vendimarrjes midis dy transmetuesve që plotësojnë kriteret, përparësi të ketë shërbimi publik.

Kryetari i Këshillit mr. Sasho Stefanovski, sqaroi se ky rekomandim nuk është përfshirë në aktet ligjore.

Këshilli i Agjencisë njëzëri e miratoi Vendimin për përcaktimin e listës së ngjarjeve me rëndësi të madhe për publikun e Republikës së Maqedonisë së Veriut, me shtimin e mëposhtëm në pikën 5, paragrafi (1), pas kriterit të katërt: "Gjatë përcaktimit të transmetuesit të kualifikuar, veçanërisht do të mirret parasysh transmetuesi i cili, përveç përmbushjes së kriterëve në fjalë, kryen veprimtari me interes publik dhe ka detyrim të ofrojë shërbime programore televizive dhe radio me rëndësi për realizimin e interesave të publikut në tërësi."

Spektori për çështje programore të informojë Komisionin Evropian dhe Komitetin e Televizionit Ndërkufitar të Këshillit të Evropës për Vendimin e sapomiratur për përcaktimin e listës së ngjarjeve me rëndësi të madhe për publikun e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Vendimi për përcaktimin e listës së ngjarjeve me rëndësi të madhe për publikun e Republikës së Maqedonisë së Veriut, hyn në fuqi ditën pas botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut".

Me ditën e hyrjes në fuqi të Vendimit për përcaktimin e listës së ngjarjeve me rëndësi të madhe për publikun e RMV-së, pushon së vlefshmi Vendimi për përcaktimin e listës së ngjarjeve me rëndësi të madhe për publikun e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr.02-1875/1 të datës 12.03.2015

**Agjencia e Shërbimeve Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,
mr. Sasho Stefanovski d.v.**

